



Prishtinë, 28 mars 2019
Kodi i ZRRE-së: V_1120_2019

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9 paragrafi 1 nënparagrafi 1.7, Nenin 25 dhe Nenin 26 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.05/L-084);
- Vendimin për lëshimin e Autorizimit Final V_402_2012 të datës 15 qershor 2012 lëshuar shoqërisë "Kelkos Energy" Sh.p.k., për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga uji, për HC "Bellaja me kapacitet të instaluar prej 8.06 MW, dhe HC Deçan me kapacitet të instaluar prej 9.8 MW, në Lumin lumëbardhi i Deçanit, komuna e Deçanit; dhe
- Shkresën e datës 01.03.2019 të Ministrit të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor të Republikës së Kosovës,

në seancën e mbajtur me datë 28 mars 2019 nxori këtë:

V E N D I M

- I. **OBLIGOHET** – shoqëria KelKos Energy SH.P.K. që brenda nëntëdhjetë **(90) ditësh, nga data e lëshimit të këtij Vendimi** të pajiset me Certifikatë të Përdorimit dhe Leje Mjedisore nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) dhe të njëjtat ti dorëzon në ZRRE, në mënyrë të pajiset me Licencë të prodhimit të energjisë elektrike.
- II. Shoqëria KelKos Energy SH.P.K., me Vendimin për Lëshimin e Autorizimit Final V_402_2012 të datës 15 qershor 2012 është autorizuar për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga Hidrocentralet në lumin Lumëbardhi i Deçanit, HC Bellaja me kapacitet të instaluar prej 8.06 MW dhe HC Deçan me kapacitet të instaluar prej 9.8 MW, Komuna e Deçanit, pas plotësimit të dëshmimeve administrative, teknike, ndërtimore dhe të mjedisit.
- III. ZRRE do të ndërmarrë veprimet ligjore për ndërprerjen e prodhimit dhe shkyçjen e gjeneratorëve HC Belaja dhe HC Deçan nga Rrjeti i Transmetimit, në rast se nuk plotësohen kushtet sipas dispozitivit nën pikën I. të këtij vendimi.

A r s y e t i m

- o ZRRE me datë 09.08.2010 nga shoqëria "Kelkos Energy" SH.P.K., ka pranuar kërkesën/aplikacionin për ndërtim të kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga uji, për HC "Bellaja me kapacitet të instaluar prej 9.2 MW, HC "Deçan" me kapacitet të instaluar prej 8.4 MW dhe HC "Lumëbardhi" 5.5 MW, Lokacioni lumi Lumëbardhi i Deçanit, komuna e Deçanit.
- o ZRRE pas konstatimit se aplikuesi ka dëshmuar përshtatshmërinë e tij për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese nga Uji, me datë 11 nëntor 2010 ka lëshuar Vendimin mbi



Njoftimin për Autorizimin Preliminar V_296_2010, dhe ka udhëzuar aplikuesin që t'i plotësoj kërkesat tjera ligjore që kërkohen me legjislacionin në fuqi në Kosovë.

- o ZRRE me datë 15 qershor 2013 ka lëshuar Vendimin për Autorizimin Final V_402_2012 shoqërisë "Kelkos Energy" Sh.p.k., për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjenerues për prodhimin e energjisë elektrike nga uji, për HC "Bellaja" me kapacitet të instaluar prej 9.2 MW, dhe HC "Deçan" me kapacitet të instaluar prej 8.4 MW Lokacioni lumi Lumëbardhi i Deçanit, komuna e Deçanit.
 - o ZRRE me datë 19.05.2016 ka lëshuar Vendimin V_813_2016 për Modifikimin e Autorizimit Final V_402_2012 për HC "Bellaja" me kapacitet të instaluar prej 8.06 MW, dhe HC "Deçan" me kapacitet të instaluar prej 9.8 MW Lokacioni lumi Lumëbardhi i Deçanit, komuna e Deçanit, sipas vendimit Nr. 1287/16 –ZSP -356 DU/16 për ndryshimin e vendimit për Lejen Ujore me Nr. 1839/11 –ZSP-69/12, të datës 09.02.2012, për HC "Bellaja", të lëshuar nga MMPH, të datës 24.03.2016 dhe vendimin Nr. 1287/16 –ZSP -355 DU/16 për ndryshimin e vendimit për Lejen Ujore me Nr. 1839/11 –ZSP-69/12, të datës 09.02.2012, për HC Deçan, të lëshuar nga MMPH, të datës 24.03.2016.
 - o ZRRE me datë 24.02.2016, nga shoqëria KelKos Energy SH.P.K., ka pranuar kërkesën për marrjen e Licencës për Prodhimin të Energjisë Elektrike, dhe pas vlerësimit të aplikacionit ka vlerësuar se mungon Leja Mjedisore e lëshuar nga MMPH, dhe nga ajo kohë e deri më tani është në pritje të sjellës së Lejes Mjedisore nga aplikuesi, në mënyrë që të lëshohet edhe licenca formale sipas Rregullës për Licencim të ZRRE-së.
 - o ZRRE me datë 19.12.2018 iu ka drejtuar me shkrim MMPH-së, për të kërkuar sqarime në lidhje me lëndët që janë në shqyrtim në ZRRE, se a janë pajisur me Leje Mjedisore gjeneratorët e BRE-ve.
 - o ZRRE me datë 22.01.2019 nga MMPH ka pranuar njoftimin Nr. 7374/18, përmes së cilës është njoftuar se citoj "*Kompania KelKos Energy SH.P.K., deri më tani nuk ka bërë kërkesë për tu pajisur me Leje Mjedisore, për prodhimin e energjisë elektrike nga HC Belaja , HC Deçan dhe HC Lumëbardhi II*".
 - o ZRRE me datë 01.03.2019 nga Ministri i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor ka pranuar "Informatë për ZRRE", me të cilën ka njoftuar se citoj "*Operatori ekonomik "KelKos Energy" SH.P.K., nuk ka përfunduar të gjitha procedurat administrative – ligjore pranë MMPH-së, për projektin " Ndërtimin e Hidrocentraleve në Lumëbardhë të Deçanit, dhe si rrjedhojë nuk janë plotësuar kriteret ligjore për operim"*
 - o MMPH, në shkresën e saj ka theksuar se përgjatë ndërtimit të HC-ve, janë përcjellur në vazhdimësi punimet nga Inspektorati i MMPH, dhe ka sqaruar se kompania KelKos Energy SH.P.K., nuk është pajisur me Leje të Përdorimit dhe Leje Mjedisore nga MMPH, për shkak se nuk ka pasur aplikime nga investitori dhe si rrjedhojë nuk janë kryer pikat 5 dhe 6 të "Informatës për ZRRE".
 - o Bordi i ZRRE, pas vlerësimit dhe analizimit të të gjitha shkresave dhe kërkesave të MMPH, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.
- IV. Shoqëria "Kelkos Energy" SH.P.K., duhet të pajiset me Leje të Përdorimit dhe Leje Mjedisore nga MMPH, brenda afatit të përcaktuar në dispozitivin nën pikën I. të këtij vendimi.





V. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.

VI. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Bordi i ZRRE-së:


Arsim Janova, u.d. kryesues


Besim Sejfiqaj, anëtar


Selman Hoti, anëtar


Izet Rushiti, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- Shoqërisë KelKos Energy SH.P.K.,
- KOSTT-it,
- Sekretarit të Përgjithshëm të MMPH-së, dhe
- Arkivit të ZRRE-së.